



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar””.

2.Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”

Relatore: Blerina Gjylameti

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryci

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati dhe Vullnet Sinaj.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi - Drejtor i Përgjithshëm i DPPP-së

Artur Kala - Kryeadministrator i AASK-së

Agim Muslia - Drejtor pranë DPPP-se

Mikeljan Shkalla - Specialist pranë DPPP-së

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar””. Relatore është zonja Blerina Gjylameti.

Kemi shqyrtimin e projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.

Relatore është zonja Blerina Gjylameti.

Të ftuar janë: zoti Elton Haxhi, zëvendësministër, zoti Elvis Koçi, drejtor i Përgjithshëm i DPPP-së, zoti Artur Kala, kryeadministrator i AASK-së, zoti Agim Muslia, drejtor pranë DPPP-së, zoti Mikeljan Shkalla, specialist pranë DPPP-së.

Unë sugjeroj që të fillojmë me një prezantim të shkurtër nga zoti zëvendësministër dhe pastaj të vazhdojmë me relatimin.

Urdhëroni, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – të nderuar anëtarë,

I nderuar zoti kryetar,

Në mbledhjen e djeshme ju patët mundësinë të diskutonit mbi paketën e ndryshimeve ligjore në kuadër të raportit Manival.

Ditën e sotme, siç ju e përmendët, kemi dy projektligje të tjera, që janë pjesë e kësaj pakete.

Për të dhënë një rezymë në parim të paketës Manival, komiteti Manival i Këshillit të Europës ka miratuar raportin e raundit të pestë të vlerësimit të kuadrit institucional ligjor dhe rregullator raportin për Shqipërinë. Ky vlerësim fokusohet...

Arben Ahmetaj – E dëgjuam dje me detaje. Unë kam qenë prezent në raport në nëntor-dhjetor 2018. Komisioni është i njohur. Ju lutem, drejtpërdrejt!

Elton Haxhi – Kemi ndryshime në dy projektligje. I pari është projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar””.

Instrumentet për ta bërë këtë një ligj që të adresojë rekomandimet e këtij raporti të Manival-it janë forcimi i integritetit të sistemit parandalues në vend.

E dyta, siguria në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë, në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave të koordinimit dhe bashkëpunimit, parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre.

E treta, zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit.

Amendamentet që përmban ky projektligj janë përpiluar në pasqyrim të gjetjeve të raportit të Manival-it në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë së sistemit në parandalimin e financimit të terrorizmit dhe zbatimit në kohë me efektivitetit të masave të kërkuara nga Këshilli i sigurimit të OKB-së.

Paketa ka si synim zbatimin e rekomandimeve. Doja të theksoja faktin se përmbushja në një kohë të shpejtë (prandaj është futur me procedurë të përshpejtuar) e të gjitha mangësive të evidentuara nga rekomandimet e Manival-it është një rëndësi e veçantë dhe kërkon një angazhim ndërinstitutional për të siguruar përputhshmërinë. Kjo do të sigurojë edhe shmangien e proceduarave të monitorimit të thelluar nga ana e FADF-së, gjë që do të kishte efekte të ndjeshme për vendin tonë.

Raportimi i radhës që ka Shqipëria në lidhje me zbatimin e rekomandimeve

Fundi i muajit qershor, prandaj dhe këto dy projektligje janë futur me procedurë të përshpejtuar.

Faleminderit!

Arben Ahmentaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar” është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen dhe sigurinë.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar, i cili përcakton standardet, si dhe nxit

zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera, që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara projektligji synon, së pari, përafrimin e plotë të kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, zvogëlimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave të koordinimit dhe bashkëpunimit, parandalimin e hyrjes të produkteve të veprave penale apo veprimtarive kriminale, si dhe fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë dhe zbulimi dhe raportimi i tyre.

Së fundi, zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, si dhe dënimin dhe heqjen e përfitimeve të paligjshme.

Qëllimi i këtij projektligji është përmbushja e detyrave të dala nga vlerësimi i komitetit Manival, pra, përafrimi me rekomandimet e FATF-së.

Ky projektligj ka kaluar nëpër një proces të gjerë konsultimi publik me të gjitha institucionet përkatëse, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, bankat e nivelit të dytë, Shoqatën e Bankave, shoqëritë e transfertave, si dhe disa takime të ndryshme, që kanë realizuar përmes përfaqësuesve të këtyre strukturave.

Në përfundim të diskutimeve janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë një pjesë e komenteve dhe propozimeve për aq sa ato nuk bien ndesh me rekomandimet e Grupit të Posaçëm FATF dhe qëllimin e ndryshimeve të propozuara.

Duke përfunduar, i ftoj anëtarët e komisioni të miratojnë projektligjin. Ndërkohë, kur ta diskutojnë nën pasqyrë, kemi disa rekomandime që duhen bërë për komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Ligjeve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kush ka pyetje?

Urdhëroni!

Blerina Gjylameti – Kam disa pyetje për përfaqësuesit e ministrisë.

1. Në çfarë mase projektligji i ri ka adresuar problematikat e rezultuara deri tani nga zbatimi i ligjit aktual, detyrimet e vendit tonë bazuar në aktet ndërkombëtare të ratifikuara, standardet e vendosura në rekomandimet e Grupit të Posaçëm?

2. A është vlerësuar apo jo përafrimi i plotë i direktivës së BE-së, 2015/849 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 20 maj 2015, mbi parandalimin dhe përdorimin e sistemeve financiare për e parave dhe financimin e terrorizmit?

3. Në lidhje me masat e gjobave konstatojmë se kufijtë minimalë dhe maksimalë propozohet të dyfishohen, ndërkohë që nuk është i qartë propozimi për heqjen e ndarjes ndërmjet gjobave të marra nga personat fizikë dhe juridikë. Do të doja të dija për efektivitetin e masave administrative të vendosura deri tani dhe si mendohet që rritja e gjobave do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të zbatimit të detyrimeve të ligjit nga njëra anë, duke shmangur dhe subjektivizmin në vendosjen e tyre nga ana tjetër.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

Artur Roshi – Në raport me gjobat që keni vendosur nga kufiri limit i poshtëm në kufirin limit të sipërm, cili është kriteri i vendosjes së këtij raporti midis dy limiteve? Cila është logjika?

Arben Ahmetaj – Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Pyetjeve të zonjës Gjylameti i përgjigjet zoti Muslia.

Faleminderit!

Agim Muslia – Përshëndetje të gjithëve!

Fillimisht, zoti kryetar, dua t’ju falënderoj personalisht, por edhe komisionin për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë drejtorisë gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së saj.

Për pyetjen e parë: “Në çfarë mase projektligji i ri ka adresuar problematikat e rezultuara deri tani nga zbatimi i ligjit aktual, detyrimet e vendit tonë bazuar në aktet ndërkombëtare të ratifikuar, standardet e vendosura në rekomandimet e Grupit të Posaçëm?”, dua të sqaroj se nëpërmjet këtij projektligji, siç është shpjeguar edhe në relacion, janë një sërë rekomandimesh të FATF-së, të cilat janë trajtuar gjerësisht. Ne mendojmë se niveli i përputhshmërisë që do të arrihet nëpërmjet miratimit të këtij projektligji do të jetë i kënaqshëm.

Për pyetjen e dytë, që ka të bëjë me përafrimin me direktivën, projektligji ka përafruar direktivën e vitit 2015 dhe pjesërisht ka bërë edhe një përfarim me direktivën e fundit të vitit 2018, siç quhet ndryshe edhe “direktiva e pestë”.

Doja që pyetjet, që janë drejtuar nga anëtarët e nderuar të komisionit, të trajtohen me një përgjigje, pikërisht për masën e gjobave, efektiviteti dhe kufiri i gjobave.

Për sa i përket masës së gjobave dhe efektivitetit të tyre ne besojmë që masat administrative të vendosura në vite kanë qenë tejet efektive dhe kjo reflektohet edhe në vlerësimin që ka marrë sektori financiar në Shqipëri, por edhe një sërë subjektesh private që kanë detyrime për raportim në bazë të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të cilat janë gjetur me një nivel të lartë përputhshmërie. Nëse doni, mund të jap edhe referencën përkatëse që ka të bëjë me rezultatin imediat katër, që është i pasqyruar gjerësisht në raportin e Manival-it që gjendet në faqen publike të këtij komiteti.

Për sa i përket kufirit të gjobave, vërtet ka një diapazon midis nivelit të ulët dhe të lartë, por në projektligj janë përcaktuar një sërë kriteresh, të cilat përcaktojnë edhe diskrecionin në vendosjen e këtyre masave administrative në varësi të madhësisë së subjektit, të shkeljeve, të përsëritjeve, të nivelit të bashkëpunimit me DPPP-në.

Ne mendojmë se rritja e këtyre masave përkon më së miri me rekomandimin përkatës që është bërë edhe në raportin e komitetit Manival.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

A ka pyetje tjetër? Nuk ka.

A ka ndonjë koment për ligjin? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë në votim në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1.

Kush ka pyetje?

Kam unë dy pyetje.

Njëra besoj se është e sqaruar, por dua që të theksohet nga ju.

Pyetja e parë ka të bëjë me konceptin që është pothuajse gjithandej në ligj, përfshirë anëtarë të familjes apo persona të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi.

Çfarë do të thotë kjo, zoti drejtor?

Cilët persona të lidhur ngushtë në marrëdhënie pune apo marrëdhënie të ngushta personale? A ka një listë definitive apo lista është e hapur?

Elvis Koçi – Persona të lidhur ngushtë me marrëdhënie biznesi ne konsiderojmë bashkortakët në një sh.p.k., konsiderojmë personat që janë emëruar administratorë të një kompanie ku ka interesa biznesi, konsiderojmë rrethin e ngushtë familjar, por nuk kufizohemi te këto.

Arben Ahmetaj – A mund t’i referoheni aneksit, nenit ligjor apo çfarëdo akti nënligjor që definon listën? Apo është në diskrecionin tuaj?

Elvis Koçi – Mund t’i jap fjalën zotit Agim, i cili e ka ndjekur nga ana juridike definicionin e saktë?

Arben Ahmetaj – Patjetër drejtor, por këto janë elemente të rëndësishme. Ju duhet të jeni të gjithë të përgatitur përderisa vini këtu të mbronin një ligj.

Unë kam qenë në anën tjetër dhe futesha në detaje teknike vetë, që në finale edhe mund të mos më takonte, vija këtu dhe merrja pyetje teknike nga komisioni deri në detaje. Kjo është një pyetje e rëndësishme për qytetarët dhe për këdo qoftë, është lista definitive.

Urdhëroni, zoti Agim!

Agim Muslia – Faleminderit, zoti kryetar!

Me lejen tuaj do të vijoj të kthej përgjigje për këtë pyetje që është shumë e rëndësishme.

Personat e ekspozuar politikisht kanë pasur një përkufizim të qartë edhe në ligjin ekzistues, pra në ligjin nr.9917 dhe janë të gjithë personat, të cilët kanë detyrimin të bëjnë deklarin e pasurive të tyre në përputhje me ligjin “Për deklarin dhe kontrollin e pasurisë”.

Pra, janë të gjithë personat që kanë detyrimin për të bërë deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë. Këtu përfshihen anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Unë kam punuar me zotin Haxhi. Kur investigohem unë, zoti Haxhi a është në marrëdhënie të ngushtë personale pune? A ka një listë definitive ligjërish e referueshme për këtë, se unë kam punuar me ju të tre. Po u investigova unë, a investigoheni edhe ju të tre ose anasjelltas, po u investiguat ju, a investigohem edhe unë?

Pra, pyetja ime është e drejtpërdrejtë, me jepni referencën ligjore të listës dhe referencën ligjore të definicionit “marrëdhënie e ngushtë personale”. Çfarë do të thotë në aspektin ligjor?

Agim Muslia – Për sa i përket listës, ne bazohemi në listën që paraqitet në mënyrë periodike, e përditësuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili përcakton qartë se cilët janë familjarët dhe personat me lidhje të ngushta biznesi.

Arben Ahmetaj - Referencën ligjore, neni kaq, paragrafi kaq, lista kaq, në mënyrë që deputetët të kenë mundësi të avancojnë në mbrojtje të kësaj pakete ligjore.

Agim Muslia – Në nenin 26 të ligjit ekzistues përcaktohet qartë detyrimi i LDKPKI-së për të përditësuar këtë listë dhe për ta dërguar në adresë të parandalimit të pastrimit të parave.

Kjo është lista së cilës ne i bazohemi në zbatimin e detyrimeve...

Arben Ahmetaj – Më falni, po lista ka një definicion të OECD-së, që ka të bëjë me konfliktin e interesit, apo nuk është kështu? Pra, OECD-ja ka nxjerrë standarde, kurse lista rezulton më e gjerë. A mund të më referoheni me ligj, ju lutem, çfarë do të thotë? Marrëdhënia e punës, që kemi ne këtu, a është një kusht që, kur investigohet, kur hetohet, kur monitorohet njëri nga ne, monitorohen të gjithë? Po ose jo, por në kuptimin ligjor, jo në kuptimin zhargonial.

Agim Muslia – Përgjigja është e thjeshtë, dhe në këtë rast është: jo.

Arben Ahmetaj – Jo, jo, Agim, s'të pyeta për rastin, sepse, në qoftë se është Blerina, ajo është person fizik, madje dhe përfaqësim juridik më vete. Apo nëse jam unë. Të pyeta në lidhje me referencën ligjore. Në qoftë se vini dhe flisni për personat e familjes apo individë të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, familja ka definicion juridik. Individët e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale nuk kanë definicion juridik. A mund të ma thoni se çfarë gjëje i referohet ky togfjalësh?

E treta: “pune dhe biznesi”. Çfarë domethënë “Pune dhe biznesi”?

Pra, dua të më sillni referencën e saktë ligjore, në mënyrë që autoritetet të kenë hapësirën e ligjit për të investiguar, ndërsa qytetarët të kenë të drejtën e ligjit për t'u mbrojtur. Kjo është shumë e rëndësishme. Nuk mund të vini me këtë hapje 360 gradë, pa iu referuar ligjit specifik. Është shumë e rëndësishme.

E dyta, kam një pyetje, që besoj se është e shpjegueshme, por dua që qytetarët dhe deputetët ta dinë deputetët. Në pikën 9, paragrafi 25 të nenit 1: “Mjet virtual është pasqyrim dixhital i një vlere, që mund të tregtohet apo të transferohet në formë dixhitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet dixhitale të monedhave të njohura zyrtarisht, si dhe nxjerrja nga Banka Qendrore e letrave me vlerë dhe mjeteve të tjera financiare, që janë parashikuar nga legjislacioni në fuqi”.

Pra, i jeni referuar kriptomonedhës. Shënojeni, sepse për kriptomonedhën nuk ka ende definicion zyrtar në legjislacionin shqiptar. Meqenëse kriptomonedha nuk është definuar, do të duhet të shkruhet: kriptomonedhë.

Çfarë keni bërë ju? Ju keni bërë një definicion, duke përjashtuar një definicion tjetër. Keni përjashtuar gjithë letrat me vlerë dhe monedhat zyrtare, për t'iu referuar kriptomonedhës. Referojuni drejtpërsëdrejti. S'keni nevojë të kapni veshin e majtë me dorën e djathtë. Kjo është.

Kini parasysh se kriptomonedha ka nevojë të rregullohet, për të definuar në transparencë të plotë portofolët personale të kriptomonedhës, në mënyrë që të ekualizohet në investigim me monedhën zyrtare. Do të duhet të vendosim edhe detyrimin për çdo individ që ka detyrimin ta deklarojë, kur është mbajtës i kriptomonedhës. Sepse nuk është ky detyrim, dhe kjo s'është gjë e mirë për sistemin. Ju duhet të kërkonit edhe në këtë legjislacion, në këtë paketë, që kriptomonedha të deklarohet specifikisht. Sepse nuk njihet si para zyrtare. Nesër del një subjekt dhe mund të thotë: s'ma ke kërkuar me ligj, që ta deklaroj, sepse nuk është monedhë zyrtare. Mund të ndodhë. Pra, një ushtrim duhet ta bëni me këtë gjë.

Këto ishin pyetjet e mia. Unë do të kërkoj nga deputetët, nga komisioni, që ta mbajë pending nenin 1, për definicionin që ju kërkoja. Definicioni është shumë i rëndësishëm.

Në seancën e dytë të kësaj mbledhjeje, që i bie të jetë pas orës 12. 30, në emër të komisionit, nëse komisioni ma lejon, kërkoj definicionin e saktë se çfarë domethënë kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk do të heqim gjë, sepse nuk do të bëjmë gropa në legjislacion, por ne duam nga autoritetet, që të sqarojnë edhe publikun, edhe ne, se çfarë domethënë ky definicion.

Pra, nëse ke punuar me dikë, e bën atë objekt? Çfarë domethënë: “marrëdhënie personale të ngushta”? Këto i duam të detajuar, që të na ndriçoni, në favor të mbështetjes së kësaj pakete të rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo që thotë zoti Angjeli në lidhje me nenin 1, është po kaq e rëndësishme. Më falni, zoti Angjeli, mund ta thoni vetë.

Anastas Angjeli – Unë kam qenë në diskutimin paraprak, të bërë me përfaqësuesit. Nuk e di, ishte drejtor dikush tjetër para jush? Ka qenë një drejtor tjetër apo e kam gabim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. kemi zhvilluar një takim me ata që erdhën, përfaqësuesit e Bashkimit European, dhe kemi bërë një diskutim në lidhje me projektin. Ka qenë një rreth i ngushtë.

Padyshim, e vlerësoj shumë punën që është bërë për gjithë këtë paketë, vetëm se duhet të kemi parasysh një moment: përputhjen edhe me pjesën tjetër të legjislacionit që kemi. Të mos e

marrim ligjin komplet, ashtu siç është, ta përkthejmë dhe ta sjellim këtu për ta miratuar ne. Në atë mbledhje, në atë takim, ne u angazhuam se që do t'i jepnim mbështetjen e plotë të gjithë paketës, në luftën kundër pastrimit të parave e të gjithave. Por, një harmonizim të paketës që keni sjellë dhe legjislacionit në fuqi, është i domosdoshëm, sidomos me ligjin e konfliktit të interesave dhe me ligjin e deklarimit të pasurive. Sepse nuk mund të sjellim këtu dy nene që janë ndryshe nga ç'janë atje, qoftë në përkufizimin e koncepteve kryesore, qoftë edhe në detaje. Për sa i përket problemit të koncepteve kryesore, zoti Ahmetaj e shprehu çështjen e përkufizimit, qoftë edhe të përfaqësimit të nocioneve që keni futur, si: “person i lidhur ngusht”. Çfarë do të thotë nga Kodi Civil apo nga një kod tjetër, “person i lidhur ngusht”? Çfarë do të thotë? Person i lidhur ngushtë është ai që bashkëjeton? Kush? Shoku? Shoqja? Domethënë, duhet të na i sqaroni këtu.

E dyta, ka një ligj, që thotë: “Pas ikjes nga funksioni të personave politikë, deklarohen edhe tre vjet pas”. Ju thoni se deklarohet pesë këtu. Domethënë, duhet një përputhje. Në funksion të asaj që deklaroi zoti Ahmetaj, në seancën e dytë, ju keni mundësi, kanë mundësi edhe juristët tanë, për t'i parë këto gjëra, megjithëse jam i sigurt se në të njëjtën kohë, Komisioni i Ligjeve bën të njëjtën gjë, sepse atë ditë që kemi bërë këtë diskutim, ka qenë edhe kryetari i Komisionit të Ligjeve, dhe është zhvilluar një diskutim shumë efektiv, sa që u arrit në prodhimin përfundimtar të dokumentacionit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pra, të shënohet edhe kjo që tha zoti Angjeli, si një konsiderim për ju, ju lutem, zëvendësministër, së bashku me drejtorët!

Siç e thashë, zoti Agim, edhe ju drejtor, së bashku me stafin e Kuvendit, në lidhje me mjetin virtual duhet ta theksoni, duhet të gjeni mënyrën teknike që t'i referohet kriptomonedhës. Është shumë e rëndësishme. Po ashtu, do të duhet të reflektojmë në lidhje me detyrimin që duhet t'u vendosim subjekteve, për të deklaruar kriptomonedhën, kur janë mbajtës të saj. Nuk ka rëndësi nëse është regjistruar apo s'është regjistruar zyrtarisht. Çdo subjekt, që nga politikanët, që nga drejtorët, që nga të gjitha subjektet e listës së detyrimit për deklarim, duhet të deklarojnë nëse kanë apo jo kriptomonedhë në portofolët e tyre. Është shumë e rëndësishme kjo gjë.

Pra, unë mendoj që nenin 1 ta lëmë pending. Besoj se jeni dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nenin 1, jo nenin 2.

Nenin 1 do ta lëmë pending, me reflektimin që do të bëni në referencën ligjore. Në rregull!

Për nenin 2, ka ndonjë pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju lutem! Po.

Blerina Gjylameti – Te neni 2 ka një ndryshim. Te shkronja ‘gj’ fjalët “avokatët, noterët” e me radhë, është hequr “noter” dhe ka dalë në vend tjetër: ‘gj 1’, ‘gj 2’, ku thuhet: “noter auditues ligjor”. Desha të dija arsyen se përse.

Atëherë, te neni 2, që është neni 3 i ligjit ekzistues, te shkronja ‘gj’, fjalët: “avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjorë, ekspertë kontabël të autorizuar, të pavarur, kontabilistë miratuar të pavarur, zyrat e konsulencës dhe profesionet e rregulluara, zëvendësohen me avokatët dhe persona të tjerë ligjorë” dhe hiqet pjesa e noterëve.

Ndërkohë, te shkronja ‘gj’, pas saj shtohen ‘gj 1’ e ‘gj 2’, e specifikuar: noterët më vete, dhe audituesit ligjorë e kontabilistët e miratuar të pavarur, më vete.

Tani, cila është arsyeja që ka ndryshuar nga shkronja ‘gj’ dhe është nxjerrë më vete: “noterët e përfaqësuesit e tjerë ligjorë dhe kontabilistët e miratuar”?

Pra, përse lind kjo nevojë, kur i kemi në germën ‘gj’ të gjithë bashkë, e ndërkohë shtojmë një germë tjetër, e cila i ndan. Mban një pjesë te germa ‘gj’, ndërsa pjesën tjetër e kalon te ‘gj 1’. Domethënë, cila është arsyeja që është ndryshuar, kur në thelb është e njëjta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S’e di sa e qartë isha në këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agim Muslia – Atëherë, në ligjin ekzistues, për noterët dhe audituesit ligjorë ka një sërë kategorizimesh, se kur duhet të plotësojnë detyrimet e tyre ndaj ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

Është konsideruar për arsye të rrezikut më të shtuar, me të cilin përballen këto dy kategori në veprimet e tyre, veçanërisht noterët dhe audituesit ligjorë. Noterët, për shkak të një sërë veprimesh që kryejnë, që për gjithë këto vite është konsideruar se paraqesin një risk më të lartë, është zgjeruar gama e transaksioneve apo e veprimeve noteriale, për të cilat duhet të zbatojnë të gjithë detyrimet, duke filluar nga vigjilenca e duhur, vigjilenca e zgjeruar, që janë të përcaktuara në ligjin aktual, por dhe që mbeten të njëjta në projektligj. E njëjta gjë është edhe për audituesit. Pak a shumë, kjo ka qenë arsyeja pse është bërë ky ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, ju lutem!

Blerina Gjylameti – Atëherë, te germa ‘gj’, përveç pjesës së audituesve ligjorë, ju i keni të përfshirë të gjithë ata që përmendët. Unë bëra një pyetje. Dakord, audituesit ligjorë janë shtuar te germa ‘gj 2’, por ndërkohë, nuk e kuptoj përse “noter” del nga germa ‘gj’ dhe shfaqet më vete te një germë e shtuar, kur në thelb nuk ka ndryshuar as koncepti e as funksioni. Thjesht kemi një ndarje.

Arben Ahmetaj – Zonja Blerina, me lejen tuaj, a mund t’ia ribëj pyetjen zotit Agim?

Pra, ajo çfarë po pyet deputetja, është fare e thjeshtë: mos hajdeni vërdallë, duke thënë: jo me një rrezik të shtuar e të tjera e të tjera. Këtu ka një togfjalësh. Togfjalëshi në ligjin aktual thotë: “avokatë e përfaqësues të tjerë ligjorë, persona fizikë dhe juridikë, që ofrojnë konsulencë juridike e financiare, dhe profesionet e rregulluara”. Pse noteri dhe audituesi ligjor, janë jashtë këtyre togfjalëshave?

Zoti Agim, a janë noteri e audituesi profesione të rregulluara, dhe konsulencë juridike ose financiare? Është? Po përse e shtoni?

Agim Muslia – Me lejen tuaj, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Po, patjetër!

Agim Muslia – Aktualisht, noterët janë subjekt i ligjit. Këtu ka vetëm një ndryshim: në përcaktimin e detyrimeve që kanë noterët dhe audituesit ligjorë. për audituesit ligjorë kemi bërë një përputhshmëri me direktivën e pestë, që përmendi...

Arben Ahmetaj – Ku, në çfarë neni e keni bërë?

Agim Muslia – Audituesit ligjorë janë shtuar për këtë qëllim, sepse nuk kanë qenë të përcaktuar...

Arben Ahmetaj – Atëherë po pyes zëvendësministrin: zoti zëvendësministër, a është audituesi ligjor një profesion i rregulluar, që jep konsulencë financiare e juridike?

Elton Haxhi – Është një subjekt i tillë. Ndryshimi në projektligj është bërë për definicionin e audituesit ligjor...

Arben Ahmetaj – Jo, definicioni i audituesit ligjor është ligj tjetër, ju e dini shumë mirë.

Elton Haxhi – Po pra, por meqë aty ka qen ekspert kontabël, dhe ligji respektiv e ndryshoi nga ekspert kontabël dhe e solli...

Arben Ahmetaj – Mirë, po ku i referohet ligji? Dakord! Një pyetje tjetër: ku i referohet ky ligj ekspertit kontabël?

Elton Haxhi – Është bërë përputhshmëria...

Arben Ahmetaj – Ku i referohet ky ligj ekspertit kontabël? I referohet edhe sikur të ishte ekspert kontabël, që prapë ka ekspertë kontabël në aspektin e profesionit, dhe jo thjesht i rregulluar. “Personat fizikë dhe juridikë, që ofrojnë konsulencë juridike e financiare dhe profesionet e rregulluara” është aty. Megjithatë, risku qëndron te fakti që, nëse e zvogëloni te “noterët e audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar të pavarur”, mund ta ngushtoni. Pra, tentoni të vini vetulla dhe nxirrni sytë. Ky është problemi.

Megjithatë, rishikojeni, që në fund, nëse është e domosdoshme ta mbajmë, nëse nuk është e domosdoshme, ta heqim. Nëse ju gjykoni se është shumë e rëndësishme, ta lëmë në ligj.

Tjetër? S’ka.

Do të kisha nevojë një qëndrim nga ana e ministrisë, në lidhje me pyetjet që bëri zonja Blerina.

Agim Muslia – Me lejen tuaj, zoti kryetar!

Për të bërë një sqarim, në germën aktuale ‘gj’, të ligjit 99/17 janë noterët, dhe është e përcaktuar që zbatojnë këtë ligj për një sërë kategorish transaksionesh, pra: kalimin e pronësisë, administrimin e llogarive bankare, administrimin e pjesëve të kapitalit, si dhe krijimin, funksionimin dhe administrimin e personave juridikë.

Ajo që po bëjmë është se po zgjerojmë gamën për noterët, po i nxjerrim nga germa ‘gj’, dhe po themi: për noterët, detyrimi në zbatimin e ligjit nuk kufizohet vetëm në këto pesë kategori.

Arben Ahmetaj – Dakord! Zoti Agim, po mbaj një qëndrim personal, dhe jo në emër të komisionit: as nuk diskutohet që s’ka nevojë ta ndash. Megjithatë, në respekt të punës suaj e të merakut tuaj, por jo të teknikës ligjore e të përfshirjes së kategorisë, ne do ta lëmë.

Por do t’ju lutem tani, se edhe dje patëm të njëjtin problem: edhe në ligjin tjetër, që do ta shohim më vonë: sillni me demek një paketë, ndërkohë që keni bërë vetëm një ndarje neni. Nuk është serioze të angazhoni parlamentin vetëm për një ndarje neni, që as nuk është e nevojshme fare.

Megjithatë, dakord!

Votojmë nenin 2, siç e ka sjellë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Te pika ‘f’ e nenit 2 thuhet: “Çdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale”. I keni përmendur edhe këtu, te pika 9, 25, mjetet virtuale. Jua tha edhe zoti Ahmetaj.

Bëni një konsultime dhe me Bankën e Shqipërisë. Si i ka konsideruar deri më sot monedhat virtuale Banka e Shqipërisë? U ka vënë një emër? Sepse “mjet virtual” do të dukej si një motoçikletë, a ku di unë. Kështu që, konsultohuni me Bankën e Shqipërisë, sepse ata kanë nxjerrë disa udhëzime, kanë nxjerrë disa akte. Ne nuk mund të nxjerrim një akt ligjor, që të përdorë nocione të reja të monedhave, në një kohë kur Banka e Shqipërisë mund t’i ketë nxjerrë ndryshe dhe ajo mund të jetë konform Bankës Qendrore Europiane. Pra, që ta dimë dhe të vendosim konceptin e duhur, sepse mund të përsëritet edhe në nene të tjera kjo punë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Deri në seancën e dytë, pas orës 12. 30, ashtu siç e theksuam më lart, dua të ketë definicion për mjetet virtuale, dua të përdoret fjala kriptomonedhë, që të mos ketë asnjë dyshim, si dhe një konsultë të shpejtë me Bankën e Shqipërisë, gjë që duhej ta kishit bërë tashmë, se aty te dera e keni, në lidhje me ndonjë definicion që mund të ketë banka.

Unë kam qenë në diskutime shumë të detajuara me Bankën e Shqipërisë, dhe jo vetëm, për sa i përket rregullimit të kriptomonedhës në të ardhmen. Pra, nuk është një çështje e panjohur për autoritetet. Përkundrazi. Do t’ju lutesha që, deri në seancën tjetër të jeni të sqaruar, me qëllim që të na sqaroni edhe ne më lidhje me ato dy gjëra që kërkoja.

Atëherë, votojmë nenin 2, me këto sugjerime.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 3. Kush ka pyetje?

Blerina Gjylameti - Ju lutem, a mund të na jepni një definicion të “organizimeve ligjore”?

Arben Ahmetaj - Zoti zëvendësministër, cili është definicioni i fjalëve “organizimet ligjore”? Nëse ti Agim, do të ishe sëmure sot, çfarë do të ndodhte?

Agim Muslia – Zoti kryetar, nuk do të lejoja të sëmuresha. Përkufizimi për “organizimet ligjore” është definicioni i ligjit aktual dhe përfshin trustet.

Zoti kryetar, pa e zgjatur shumë diskutimin jemi munduar, nuk është e lehtë, por të mbajmë një lloj koherence me mënyrën sesi përkufizohen gjëra tëaktuara në nivel ndërkombëtar

edhe në standarde me përkufizimet tona. Trustet, për informacionin tuaj nuk janë problem shqiptare, sepse ne nuk e kemi ligjin anglosakson që e njeh trustin, por ka dalë si problem në raportin e raundit 4 dhe 5 që pavarësisht se Shqipëria nuk e njeh konceptin e trustit, kjo nuk pengon dikë që të vijë dhe të përfaqësojë një trust të organizuar diku jashtë vendit dhe të vendosë marrëdhënie biznesi në Shqipëri.

Arben Ahmetaj - Në aspektin juridik çdo trust që mund të vijë këtu, do të regjistrohet në formën që shteti shqiptar detyron në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare”. Megjithatë meqenëse ju bëni *check-list* të kërkesave që nuk duhet të jenë *apriori*, por të detajuara juridikisht, këto shoqërohen me definicione në preambulën e ligjit. Për “organizimet ligjore”, a keni definicion në preambulën e ligjit aktual?

Agim Muslia - Në ligjin aktual është “organizimi ligjor”.

Arben Ahmetaj- Është trusti?

Dakord. Ka pyetje tjetër? Nuk ka.

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Në pikën 2 keni vënë përsëri: këshilltar, menaxherë. Çfarë këshilltarësh, menaxherë, kontabilistë? Do ta lemë “kontabilistë”, apo siç është në nenin 2 “kontabilistët e miratuar të pavarur”? Kontabilist është edhe llogaritari që ka kompania. Ju e keni fjalën edhe për ata apo e keni për kontabilistin e miratuar?

Arben Ahmetaj – Pra, për profesionin e rregulluar apo për profesionin?

Anastas Angjeli – Se kështu siç e keni vënë...

Agim Muslia – Kontabilist përfshin edhe ata të punësuarit, jo vetëm ata...

Arben Ahmetaj – Ne e dimë se çfarë është kontabilisti, na ka lidhur puna 2-3 vjetet e fundit, por jeni duke iu referuar audituesit ligjor apo një të punësuar, një llogaritari? Kjo gjë duhet të theksohet. Çfarë ju ka sugjeruar Moneyval-i në këtë aspekt?

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi- Është lënë i pa përkufizuar siç e kërkoi zoti Angjeli për faktin sepse është më gjithëpërfshirës, pra kontabilist jo thjesht të miratuar...

Arben Ahmetaj – Pra edhe financierin e kompanisë e ke fjalën apo jo?

Elton Haxhi – Po, Po. Mund të shtojmë dhe diçka?

Arben Ahmetaj – Ka pyetje? A mund të na sillni në komision standardin që i jeni referuar?

Agim Muslia– Me lejen tuaj, zoti Kryetar!

Në relacion ne kemi vënë edhe referencat për kriteret e rekomandimit 25, përkatësisht janë: 25/1 dhe 25/3.

Arben Ahmetaj – Mund të kemi 25/1 dhe 25/3 ku i referoheni?

Agim Muslia– Unë e kam këtu përpara.

Arben Ahmetaj – Mund ta lexosh?

Agim Muslia– Por është në anglisht.

Arben Ahmetaj – Ska gjë...

Agim Muslia– Por dhe tek profesionet e lira. Nuk po përmënd termin anglisht, po kjo nënkuptohet, profesionet e lira kur vendosin një mardhënie biznesi ose kryejnë transaksione rastësore. Pra përcaktohet që në momentin që vendos një mardhënie biznesi, këto lloj organizimesh duhet të japin të gjithë këtë informacion për institucionet financiare. Po përmënd vetëm pjesën që ka të bëjë me kontabilistët. Duhet të mbajnë informacion thelbësor në lidhje me agjentët e rregulluar, me ofruesit e shërbimeve të trusteve, duke përfshirë ofruesit e shërbimit që është një term, i cili nuk përdoret në Shqipëri: këshilltarët e investimeve, administratorët, kontabilistët dhe këshilltarët fiskalë.

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4. Kush ka pyetje? Nuk ka. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Kemi disa fjalë ligjore, për shembull: “ në rast të organizimeve ligjore kjo përfshin identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to”. Kujdestari, që ta dini nuk është term financiar në Shqipëri.

Në mbështetje të punës suaj në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, ne e kalojmë. Po, kujdestari i kujt është? I fëmijës, i një pensionisti që ka nevojë për një kujdestar, kontabilist financiar apo ai që ka përgjegjësi ligjore ose përfaqësim ligjor?

Ju lutem, janë definancione shumë të rëndësishme, janë ligje që mbeten këtu dhe do të afektojnë përveç nesh, brezat që vijnë, sepse janë ligje shumë të rëndësishme, janë themeltarë për punën e institucioneve dhe për jetën e çdo njeriu.

E dyta, “Rreziqet e pastrimit të parave”, germa “c”, nënndarja 3: “Rreziqet e pastrimit të parave, e financimit të terrorizmit të menaxhohen në mënyrë efektive”. Çfarë do të thotë “në mënyrë efektive?”. Nuk dua të mbaj qëndrim të kësaj natyre, por keni një jetë që... Po ju lutem.

Agim Muslia - Për pjesën e kujdestarëve, i vetmi përkufizim që ekziston është në konventën e Hagës, neni 2, nuk ka asnjë përkufizim tjetër..

Arben Ahmetaj - E keni adaptuar në ligj?

Agim Muslia – Nuk e kemi përfshirë në ligj, por kemi thënë vetëm...

Arben Ahmetaj - Do të ishte e rëndësishme se nesër për shkak të mungesës së definicionit kujdestarët e vërtetë financiarë mund të kenë shmangie, sepse mund të të hedhin nesër në gjyq kur ti investigon dhe të të thonë: “Çfarë do të thotë kujdestar?”. Gjykata do të vendosë ose, jo, por po e bëj si ushtrim, ne e kemi këtë zakon edhe kur kemi punuar bashkë, por edhe tani të gjithë deputetët, bëjmë nga një ushtrim për të kuptuar thelbin e gjësë. Gjykata do të thotë: “Nuk ka definicion për kujdestarë”. Vazhdon kujdestari rrugën e lirë në atë që po bën, që mund të jetë edhe e kundërligjshme, që do të thotë se ka nevojë të adoptohet definicioni.

Besoj se duhet shënuar, që të punohet me ministrinë. Unë nuk e di nëse ligji do të jetë gati për javën tjetër, por ne do të mundohemi që ta bëjmë gati për javën tjetër, me këto që po lëmë si detyra.

Nenin 5, po e lëmë *pending* për definicionet apo jo, s i edhe riformimin e togfjalëshit “në mënyrë efektive”. A ka ndonjë referencë?

Agim Muslia - Zoti kryetar, këtu bëhet fjalë për rastet. Për vetë specifikën që kanë trustet, është lënë mundësia të vendoset një marrëdhënie biznesi dhe pa prezencën fizike që është kryefjala dhe kallëzuesi i çdo veprimi që bëhet në kuadrin e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, në kuadrin e vendosjes së marrëdhënies së biznesit.

Kjo është e bazuar në rekomandime.

Arben Ahmetaj – Rekomandimet nuk janë ligje, janë rekomandime

Agim Muslia – Është e vërtetë. Çdo subjekt i ligjit ka detyrimin të ketë një vlerësim të riskut të klientit të tij, që nënkupton...

Blerina Gjylameti – Kam një sugjerim, te pika 2. Pas pikës 1 të shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje. Unë mendoj se duhet të ketë një riformulim të kësaj pike, për shkak se nga mënyra sesi është shprehur krijon konfuzion, nuk ka qartësi.

Arben Ahmetaj - Cila pjesë konkretisht?

Blerina Gjylameti - “Subjektet verifikojnë se çdo person që pretendon të veprojë në emër të klientit të tyre”, çfarë verifikojnë? Është i autorizuar për veprimet e kërkuara...

Arben Ahmetaj - Në këndvështrimin tim është e qartë. Nëse unë veproj në emrin tuaj dhe jam duke bërë transaksione me Ministrinë e Financave, kjo e fundit më kërkon: a jam vërtet i autorizuar? Në këtë rast kërkon autorizimin prej jush, që unë ta paraqes kur të bëj transaksionet ose veprimin e biznesit. Është e qartë.

Blerina Gjylameti – Ka edhe diçka, prandaj duhet ta kisha përfunduar: “ si edhe të identifikojë dhe të verifikojë identitetin e personit të autorizuar”. Flasim për subjekte, në shumës dhe më pas flasim për person, prandaj them që të riformulohet. Jo ndryshim në thelb.

Arben Ahmetaj – Dakord, besoj se është e qartë, por shërbimi i Kuvendit të merret me pjesën e korrektimit të fjalës.

Neni 1 dhe neni 5 kanë mbetur *pending*.

Neni 6. Ka pyetje?

Blerina Gjylameti - Te neni 6, komisioni ynë i rekomandon komisionit përgjegjës, sa më poshtë: “ Në nenin 6 të projektligjit, te pika 1 e nenit të shtuar 4/2 rekomandohet të rishikohet referenca ligjore në aneksin 2 të direktivës së BE-së 2015/849 të Parlamentit Europian dhe të KE-së të datës 20.05. 2015, pasi një akt i BE-së nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar dhe si i tillë nuk mund të shërbejë si referencë detyruese. Prandaj sugjerojmë që ky aneks mund të bëhet edhe pjesë e këtij ligji.

Arben Ahmetaj - Direktiva është referencë në punën tonë, në programimin tonë dhe në reformat që ndërmarrim, por në legjislacionin shqiptar përmendet, zakonisht nga eksperiencia ime modeste, në relacione dhe jo në nen.

Do t’ju lutem që të bisedohet me shërbimet e Kuvendit që ta kalojmë në aneks. A ka ndonjë koment tjetër për nenin? Nuk ka. Praktikisht këtu kemi dy definicione të vigjilencës: “vigjilencën e thjeshtuar dhe ajo e duhur, e zgjeruar”. Çfarë është “vigjilenca e duhur”?

Agim Muslia – Zoti kryetar, “vigjilenca e duhur dhe e zgjeruar” janë të përkufizuara në ligj aktualisht. Ne kemi shtuar “vigjilencën e thjeshtuar”.

Do të bëj vetëm një sqarim shumë të shkurtër. Ne u kërkojmë subjekteve të ligjit që të përdorin qasjen e bazuar mbi riskun, që nënkupton vigjilencën e duhur dhe të zgjeruar se ka një element normal të vigjilencës e duhur dhe e zgjeruar, është më e përforcuar, por ka edhe një nivel më të...

Arben Ahmetaj - Janë më të detajuara apo jo?

Agim Muslia - Po, këtë kemi shtuar.

Arben Ahmetaj – Janë të detajuara si procedura.

Anastas Angjeli - Më poshtë keni bërë një pikë ku e dalloni dhe thoni: “Ka vëmendje të zgjeruar”. Meqenëse pyetëm për diferencën midis dy vigjilencave po pyes edhe për diferencën midis “vëmendjes së veçantë”. Ku dallon “vigjilenca e zgjeruar” nga “vëmendja e veçantë?” Doni t’jua them se ku është vëmendja e veçantë? E keni te pika 7 e nenit 11. Nuk janë dy koncepte, por tri.

Arben Ahmetaj - E qartë. Do t’u sugjeroja përfaqësuesve të ministrisë, që kur ka komente të kësaj natyre nga deputetët të cilat nuk janë të referuara në definicione zyrtare, t’u referohemi rekomandimeve dhe të shtojmë definicionet, në mënyrë që ta bëjmë punën tonë pak më të thjeshtë dhe më transparente.

Anastas Angjeli - Nëse në ligjin ekzistues ka definicione, shtoni edhe këtu që në fillim: “Në pikën kaq të definicioneve, shtohen këto që tha zoti Ahmetaj 1, 2, 3, 4 dhe 5”.

Arben Ahmetaj - Zoti Koçi, zoti Muslia praktikisht meqenëse kemi rekomandime të reja nga Manival, të cilat e zgjerojnë gamën, në këndvështrimin tim ka nevojë për rifreskim të definicioneve në mënyrë që të dyja elementet t’i kemi parasysh në të njëjtën kohë.

E para, kur zgjerohemi, të mos zgjerohemi pa definicione të sakta, në mënyrë që autoritetet të kenë hapësirë të bëjnë punën, qytetarët të kenë mundësi që në referencë të të drejtave të tyre universale, të drejtave të njeriut të jenë të mbrojtur nga ligji.

E dyta, në punën tuja të përditshme nesër të jeni shumë të qartë në bazë të definicioneve, sepse unë ju bëra një ushtrim, po atë ushtrim njerëz që shkelin ligjin e bëjnë vetëm për të kundërshtuar penalitetet nga autoritetet, e bëjnë në mënyrë shumë më të sofistikuar se këto ushtrime që tentojmë ne në funksion të transparencës së ligjit dhe të përmirësimit të tij. Të jeni të sigurt, shfrytëzoni këtë moment që t’i bëni të dyja gjërat njëherësh.

E para, të definoni qartë procedurat tuaja, që t’ju lehtësohet puna në favor të luftës kundër financimit të terrorizmit dhe parandalimit të pastrimit të parave, por nga ana tjetër kemi edhe qytetarët që kanë domosdoshmëri të kenë një ligj të qartë për dy arsye thelbësore, ta zbatojnë qartësisht dhe të drejtat të mos ju shkelen asnjëherë. Ky është i gjithë thelbi i asaj që dua të them.

Për shkak të një axhende urgjente që kemi do të duhet ta ndërpresim takimin për të vazhduar pas orës 12:30.

Së fundi, mos harroni edhe një element tjetër shumë të rëndësishëm, që ka të bëjë me qytetarë, prindër, fëmijë, vëllezër apo motra emigrantësh nga Anglia, Italia apo vende të tjera, të cilët marrin transferta parash të rregullta. Në një takim që kemi pasur me bankat e nivelit të dytë (kam përshtypjen se ka qenë dikush nga ju) ka pasur ankesa për procedimin që bëhet për pastrim parash. Për mendimin tim duhet të shikoni konceptin e listës së bardhë të bankave. Pavarësisht se definicioni është apo nuk është ligjor (kjo duhet parë nga ana juaj, sepse prandaj jeni ekspertë), për dërgesat e emigrantëve apo të individëve nga bankat e bardha në Bashkimin Europian, në shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në listën e bardhë të bankave, të cilat janë immune ndaj pastrimit të parash, për mendimin tim, nuk është e nevojshme të fillojë një proces i ri i verifikimit i dërguesit dhe marrësit, ku shkohet edhe në ndjekje penale.

Drejtori i njëres nga bankat më të mëdha të nivelit të dytë në vend në një takim zyrtar solli një shembull ku Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave kishte proceduar dhe çuar në prokurori një grua të moshës 65-67 vjeç për 50 paund. Keni parasysh të konsultohemi me partnerët për funksionimin e listës së bardhë ose filtrin e bankave dërguese, sidomos për transfertat e vogla të emigrantëve për prindërit ose familjet.

Ky është sugjerimi im për ju.

Ka ndonjë pyetje tjetër për nenin 6?

Kush është pro me sugjerimin dhe ndryshimin që kërkoi komisioni për sa i përket referimit të direktivës? Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Kush ka pyetje?

Blerina Gjylameti - Neni 7 germa dh ka të bëj me përkufizimin e kujdestarit

Arben Ahmetaj - Të gjitha këto i rekomandohen Komisionit përgjegjës të Ligjeve.

Kini parasysh që në punën tonë, meqë jemi komision për dhënie mendimi, duhet të bëjmë faktet dhe kërkesat që kemi për komisionin.

(Mungesë incizimi)

... zonja Blerina.

Kush është pro nenit 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Artur Roshi – Mendoj që ka përsëritje te germa “a”, autoriteti që e ka lëshuar.

Nuk besoj se kemi disa autoritete që japin disa numra personal.

Arben Ahmetaj – *(Mungesë incizimi)*

Kush është pro? Kundër. Abstenim?

Miratohet.

Këtu e mbyllim seancën e parë të takimit, me detyrat që lamë për përfaqësuesit e ministrisë.

Nenet 1 dhe 5 janë *pending* për ato që folëm.

Bëni konsultimet tuaja të domosdoshme dhe bashkëpunoni me shërbimin e Kuvendit për sqarimin e togfjalëshit se ku shkon gjerësia dhe a ka referencë ligjore, e dyta, konsultimi për mjetet virtuale dhe e treta, definicionet që ju referuam, në mënyrë që të bëjmë ndryshime që t'i vlejné autoritetit, autoriteteve dhe qytetarëve.

Faleminderit dhe shihemi në orën 12:30.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti